

SHENIMET SHPJEGUESE PER BILANCIN E AKTIVITETIT TE MBYLLUR TE VITIT 2019

PER SHOQERINE "INFINIT" SH.P.K

A) DISA SQARIME NE LIDHJE ME SHENIMET SHPJEGUESE PER BILANCIN E VITIT 2019

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2. Shënimet shpjeguese në këtë bilanc japin përshkrime me fjalë ose zbërthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rreth zërave që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra.

Shënimet shpjeguese japin: (a) informacione në lidhje me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikat specifike kontabël të përdorura; (b) informacion shpjegues të kërkuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit i cili nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe (c) informacion që nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare por është i nevojshëm për të kuptuar ndonjë prej tyre.

Kjo njësi ekonomike normalisht i paraqet shënimet shpjeguese në rendin e mëposhtëm:

A). Një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

B). Një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara;

C). Informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës;

D). Shënime të tjera shpjeguese.

Dhënia e informacioneve shpjeguese nga kjo njësi ekonomike për politikat kontabël

Kjo njësi ekonomike më poshtë do të japë informacion shpjegues në vijim në përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël:

a). Baza e matjes (ose bazat) të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare;

b). Politikat e tjera kontabël të përdorura, të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.

Dhënia e Informacioneve në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Njësia ekonomike **"INFINIT" SH.P.K** kur e shikon të arsyeshme mund të japë informacione në shënimet shpjeguese rreth supozimeve kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, të cilat ka shumë mundësi të sjellin një rregullim material në vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përsa i përket këtyre aktiveve dhe detyrimeve, shënimet shpjeguese përfshijnë detajet për:

a). Natyrën e tyre;

b) Vlerën e tyre kontabël në fund të periudhës raportuese.

Dhënia e Informacioneve në lidhje me "Palët e lidhura" dhe Shpjegime për këto palë

Njësia ekonomike **"INFINIT" SH.P.K** konsiderohet si e lidhur, me një palë tjetër nëse njera palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenca e kontrollit, kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivitete biznesi me njera-tjetrën. Prandaj, për t'i kuptuar sa më mirë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, duhet të kuptohen mirë marrëdhëniet dhe kushtet, në të cilat palët e lidhura hyjnë në aktivitete biznesi me njera-tjetrën. Shembuj të palëve të lidhura përfshijnë: (a) njësia mëmë (dhe personat që kontrollojnë ose kanë ndikim të ndjeshëm mbi njësinë mëmë); (b) njësitë e kontrolluara; (c) pjesëmarrjet; (d) sipërmarrje të tjera të të njëjtit grup konsolidimi (për shembull, njësitë e kontrolluara simotra); (e) drejtuesit, anëtarët e organit mbikëqyrës si dhe aksionarët që zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të aksioneve, me përjashtim të atyre rasteve kur këta persona nuk e kanë mundësinë praktike të ushtrojnë influencë të ndjeshme mbi vendimet ekonomike të njësisë ekonomike raportuese; (f) të afërmit e ngushtë të personave të përmendur në pikën (e) (përfshirë

këtu personat e afërt dhe fëmijët) si dhe njësitë ekonomike që janë nën kontrollin ose ndikimin e tyre. Njësia ekonomike **"INFINIT" SH.P.K** nuk është e lidhur me ndonjë palë tjetër.

Përveç kërkesave të këtij standardi çdo standard tjetër i SKK-ve kërkon dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse. Plotesimi i të dhenave të kësaj pjese është bërë sipas kërkesave dhe strukturës standarde të percaktuara në SKK 2 dhe në SKK-të tjera 3-14 dhe konkretisht, radha e dhënies së shpjegimeve është si vijon:

a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël

b) Shënime që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare

c) Shënime të tjera shpjeguese

B) INFORMACION I PËRGJITHSHËM PER PASQYRËN E PERFORMANCËS TË HARTUAR NË MBYLLJE TË AKTIVITETIT EKONOMIK E FINANCIAR TË KRYER GJATË VITIT 2019

Kuadri ligjor:

Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri kontabel i aplikuar :

Standardet Kombetare të Kontabilitetit në Shqipëri. (SKK 2; 49)

Baza e përgatitjes së PF :

Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara. (SKK 1, 35)

Parimet dhe karakteristikat çesore të përdorura për hartimin e P.F. : (SKK 1; 37 - 69)

a) NJËSIA EKONOMIKE RAPORTUSE **"INFINIT" SH.P.K** mban në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe ka raportuar të gjitha trasaksionet

b) VIJIMESIA e veprimtarisë ekonomike të njësive sone raportuese është e realizuar duke siguruar vazhdimësi dhe duke mos pasur në plan ose nevojë për ndërprerjen e aktivitetit të saj.

c) KOMPENSIM midis një aktivi dhe një pasivi është bërë në rastin kur personi juridik ose fizik paraqitet si klient dhe si furnitor njëkohësisht vetëm në rastet që lejohen nga SKK.

d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë në mënyrë që informacioni i paraqitur të jetë i standartizuar, i qartë dhe i kuptueshëm për përdorues që kanë njohuri të përgjithshme dhe të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

e) MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë të hartuara vetëm për zera materiale.

f) BESUSHMERIA për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguruar nepermjet punës së kujdesshme duke ruajtur vijimesinë me kusht që të gjithë zërat e bilancit të jenë material duke respektuar kërkesat e SKK-ve. Për ndërtimin e pasqyrave financiare me të gjithë elementet e prezantuar në to si kërkesa bazë ka qenë dhe mbetet zbatimi i SKK-ve.

Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare të vitit 2019 janë ndërtuar sipas SKK-ve - referuar nën 4 të ligjit nr 9228 datë 29.04.2004. "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Në ndërtimin e pasqyrave financiare ndryshojnë format e BK e të PASH sepse janë zbatuar kërkesat e SKK2. Shifrat e vitit 2019 janë bërë të krahasueshme me ato të vitit parardhës 2009-2015. Për realizimin e kësaj detyre janë bërë të gjitha rregullimet e mundshme me qëllim që informacioni kontabel të krahasohet në dinamikë.

Lista e llogarive të përdorur për vitin 2019 është ajo e publikuar nga "Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit" dhe është e përshtatur për zbatimin sa më të plotë të SKK-ve gjatë vitit 2019.

Për mbajtjen e inventareve janë përcaktuar metodat e inventarizimit dhe mënyra e vlerësimit të tyre, me qëllim që të jenë të plotësuar kërkesat e SKK 4. 15 dhe konkretisht:

a) Për lëndet e para, për produktet e gatshme dhe për mallrat është përdorur mënyra e inventarizimit të vazhdueshëm ndërsa vlerësimi i tyre është bërë me metodën "Vlerësim me kosto mesatare të ponderuar".

b) Per artikujt ushqimore eshte perdorur inventarizimi i ndermjetem bazuar ne metoden e "Vleresimit me kosto mesatare te ponderuar "SKK 4,15".

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte bere me koston e plote (SKK 5; 11). Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua, koston e huamarrjes deri ne perfshirjen e aktivitetit plotesisht ne bilanc (plus interesat) kapitalizohen ne koston e aktivitetit vetem per periudhen e investimit deri ne perfundimin e tij (SSK5:16).

Me pas kur AAM-ja eshte marre ne kontabilitet si i tillle, interesat dhe koston e tjera te huamarrjeve i jane ngarkuar rezultatit te vitit ushtrimor te aktivitetit duke u bazuar ne te dhenat konkrete te amortizimit te kredive te marra nga njesia ekonomike.

Per vleresimin e mepasshem te një AAM-je eshte zgjedhur modeli i koston fillestare te fiksuar duke e paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar (SKK 5; 21).

Per llogaritjen e amortizimit te AAM-ve (SKK 5: 38) jane perdorur metodat e pranuar nga Ligji per "Tatimin mbi te ardhurat" ku si metode e amortizimit te ndertesave perdorim metoden lineare mbi vlerën e mbetur por dhe per AAM-te e tjera perdorim metoden lineare te llogaritjes se shpenzimeve të amortizimit mbi bazen e vlefte se mbetur te AAM-ve. Normat e amortizimit jane te njejta me ato te pranuar nga sistemi fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat ne menyre lineare mbi vleren e mbetur deri me 5 % ne vit.
- për kompjutera e sisteme informacioni deri me 25 % te vlefte se mbetur
- Për të gjitha AAM-të e tjera deri me 20 % te vlefte se mbetur.

Mbajtja e kontabilitetit eshte realizuar ne menyre kompjuterike me programin ALPHA.

C) SHPJEGIME DHE KOMENTE PER TREGUESIT E VENDOSUR NE BILANCIN E VITIT

2019

Aktivet monetare ne masen 4.702.390 lek perbejne mjetet monetare te cilat ndodhen ne llogarite bankare dhe ne arke. Rezultatet konkrete jepen ne pasqyren shoqeruese per keto shenime bashkangjitur ketij materiali. Aty jane dhene konkretisht llojet e monedhave dhe llojet e llogarive ne monedha te ndryshme per bankat dhe per arken. Gjëndja e arkës në lek më 31.12.2019 është koncretisht 0.00 lek.

Llogarite e kerkesave te arketueshme perbejne nje burim te rendesishem te sigurt per vazhdimin normal te biznesit . Kerkesat e arketueshme ne lidhje me klientet per vitin 2019 jane në masën 15.450.000.00 lek. Kjo shoqeri nuk ka kerkesa te tjera te arketueshme . Tatim fitimin të mbi paguar per vitin 2019 nuk ka sepse "Njësia ekonomike" del me pagesë 1.804.693 Detyrimet ndaj furnitoreve jane vetem 4.429.277.00 lek. TVSH-ja kreditore është në masën 400058.00 lek, Tatim-fitimi detyrim për vitin 2019 ka ne masen 1.804.693 leke.

Ne lidhje me inventaret dhe mallrat per rishitje jane paraqitur gjendjet dhe levizjet e magazinave te lendeve te para dhe te mallrave te cilat i bashkangjiten materialit.

Per aktivet afatgjata materiale jane zbatuar kerkesat e (SKK 5:90,91,92,93). Ato jane te shprehura ne pasqyrat qe i bashkangjiten materialit. Konkretisht jane dy tabela. Njera shpreh llojshmerine dhe vleren fillestare per secilin aktiv ne momentin e marrjes ne kontabilitet kurse tjetra shpreh amortizimin e akumuluar dhe amortizimin e llogaritur te AAMve sipas grupeve.

Gjithashtu ketu jepen edhe hyrje daljet e aktiveve ne grupe gjate vitit te cilat perbejne ato qe quhen ndryshime ne inventarin e Aktiveve afatgjata materiale.

Ne detyrimet e pasivit vendin kryesor e ze një kredi e marrë në F I Bank për mjete xhiro.

Detyrimet e tjera jane te zakonshme dhe likujdimi i tyre ka ndjekur dhe vazhdon te ndjeke rrjedhen normale duke u likujduar sipas kontratave ose sipas parimit te renies dakord.

Detyrimet tatimore ne masen 497088.00 lek perbejne përbëhen nga sigurimet shoqerore dhe pagat qe ka rrjedhur nga aktiviteti i muajit Dhjetor te vitit 2019 Ne muajin Janar 2020 ato jane likujduar në masën totalisht..

Gjithë kapitali i “Njesisë ekonomike” “**INFINIT SH.P.K**” është i percaktuar sakte neper llogarite perkatese. Fitimi neto i viti ushtrimor 2019 është ne masen 21.609.047.00 lek. Fitimet neto janë te patatuara me dividend. Kjo Njësi ekonomike” nuk ka shperndare asnje vit dividend.

Per te analizuar te dhena me te hollesishme per secilin ze te bilancit dhe per te gjetur ndikimin e faktoreve ne nivelin e tregueseve baze duhet ti referohemi gjendjes se llogarive ne materialet bashkangjitur dhe me tej karteles per secilen llogari.

Kjo “Njësi ekonomike” nuk ka krijuar provizione për detyrimet aktuale, për të cilin koha e shlyerjes së tyre ose shumat e tyre janë të pasigurta.

Në lidhje me qiratë shprehim se “Qiraja është një marrëveshje ku qiradhënësi i kalon qiramarrësit të drejtën e përdorimit të një aktivi për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt një ose disa pagesave. “Qiratë e zkonshme janë marrë në shpenzime dhe nuk ka të ardhura të shtyra apo shpenzime qiraje të shtyra në këtë “Njësi ekonomike”.

Qiraja financiare është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivit. Titulli mund t'i kalojë ose jo qiramarrësit Kjo “Njësi ekonomike” nuk ka qira të tilla

D) SHPJEGIME DHE KOMENTE PER TREGUESIT E VENDOSUR NE “PASQYREN E TE ARDHURAVE DHE TE SHPENZIMEVE PER VITIN 2019.

PASHja është paraqitur për të ardhura dhe shpenzime sipas natyrës në të gjithë elementet përberes të saj.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital). Burimi kryesor i të ardhurave të kësaj njësie ekonomike është shitja e PUNIMEVE dhe e produkteve të gatshme. Burime të tjera, si interesi përbëjnë një element tjetër të të ardhurave.

Ne bilanc shpenzimet janë paraqitur sipas natyrës së tyre për materiale, paga, tatime dhe taksa, amortizime dhe shpenzime të tjera. Ne zerin shpenzime të tjera kryesisht janë përfshirë ato të natyrës së shpenzimeve të pa njohura nga fisku.

Te gjitha llogarite e te ardhurave jane mbajtur me kartela analitike te vecanta dhe ne to del qarte burimi se si jane siguruar keto te ardhura.

Kjo shoqëri ka si baze punimet e ndertimit.

Pasqyra e flukseve të parase është ndertuar sipas metodës indirekte ndërsa pasqyra e levizjes së kapitalit është ndertuar në baze të të dhënave të regjistruara në kontabilitet sipas kërkesave të SKK 2.

D)DISA SHPJEGIME NE LIDHJE ME TATIMET AKTUALE DHE ME TATIMET E SHTYRA.

Ne kete bilanc jane vendosur disa tatime te shtyra ne pozicionin debitor dhe disa tatime aktuale te tjera ne pozicionin kreditor per te cilat ja nuk vlen te sqarojme .

TVSH-ja debitore “Në debit ë bilancit) është në masen 3.189.061.00 lek. Kjo shoqëri duhet të paguaje Tatim fitimi shtese per vitin 2019 në masën 3.230.600.00 lek. detyrimet e tjera tatimore për sigurimet shoqërore janë në rrjedhën normale të tyre normale.

F) INFORMACION RRETH GJYKIMEVE DHE RRETH BURIMEVE KYÇE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT

Vlerësimi i inventareve si për AAM-të për, për mallrat, për lëndët e para dhe për materialet gjëndje më 31.12.2019 është i saktë. Pasiguri ka në vlerësimin e kërkesave të arkëtueshme dhe të detyrimeve të pagushme të cilat kanë ndryshim të madh. Vlera e lartë e gjëndjes së llogarisë 455 krijon bindjen që mund të ekzistojnë pa saktësi në lëvizjen e monedhave nga arka në bankë e anasjelltas.

Deklarimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve ka një nivel të caktuar pasigurie e cila është relativisht e pa përfillshme . Burimet e financimit të investimeve mbulohen dhe tejkalohen disa herë tërësisht me fitimet neto të realizuara gjatë vitit ushtrimor dhe me kreditë dhe oëerdraftet e marra por kjo analizë për

ne përbën pasiguri për shkak se për disa AAM nuk janë regjistruar në llogaritë e shoqërisë por janë pronë personale. Pasiguri në vërtetësinë e të dhënave ka dhe për faktin se nuk janë deklaruar tërësisht huamarrjet dhe huadhënjet private apo marrdhënjet e tjera financiare me palë të treta.

Pjesët perberse të bilancit të shoqërisë **INFINIT** SH.P.K janë

- | | |
|---|------------|
| • Bilanci Aktiv - Pasiv. | Dy flete. |
| • Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve | Nje flete |
| • Pasqyra e flukseve të parase sipas metodës indirekte | Nje flete. |
| • Pasqyra e levizjes së kapitalit | Nje flete |
| • Listat e inventareve të mallrave dhe të materialeve me 31.12.2019 | Nje flete |
| • Tabela e llogaritjes së amortizimit për vitin 2019 | Nje flete |
| • Pasqyra për inventarin e mjeteve të transportit për vitin 2019 | Nje flete |
| • Shenime shpjeguese | 5 flete |
| • Formulare Statistikore | Tre flete |

Shenim Bilanci është hartuar në katër kopje dhe një kopje elektronike kopje dhe të gjitha janë të lidhura dhe të vulosura e firmosura në të njëjtën formë.

Hartuesi

ABAZ ÇOBANI

Administratori

VALENTINA BREGU

